

# KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

RRETH NESH

NJOFTIME

SEANCA PLENARE

LEGJISLACION

PROGRAMI I TRANSPARENCËS

SEANCË DËGJIMORE

## NJOFTIM PËR MEDIA Seanca plenare datë 16.09.2022

BY KLP 16/09/2022 AKTIVITETE, PËR MEDIAT



Këshilli i Lartë i Prokurorisë zhvilloi ditën e premte, më 16.09.2022, mbledhjen plenare të radhës, në prani të 9 anëtarëve të Këshillit, e në prani të përfaqësuesve të misionit OPDAT dhe medias.

# KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

[RRETH NESH](#)[NJOFTIME](#)[SEANCA PLENARE](#)[LEGJISLACION](#)[PROGRAMI I TRANSPARENCËS](#)[SEANCË DËGJIMORE](#)

- caktimin e përkohshëm të z. Kleanth Zeka, në detyrën e Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Vlorë;
- caktimin e përkohshëm të zj. Elida Hoxhaj, në detyrën e prokurores në Prokurorinë e Apelit Vlorë;
- caktimin e përkohshëm të zj. Pranvera Gruda në detyrën e prokurores në Prokurorinë e Apelit Shkodër;
- caktimin e përkohshëm të z. Rifat Kojku, në detyrën e Drejtuesit të Prokurorisë Dibër;
- transferimin me pëlqim të z. Elion Mustafaj nga Prokuroria e Vlorës në Prokurorinë Lushnje;
- caktimin e përkohshëm të z. Elion Mustafaj në detyrën e Drejtuesit të Prokurorisë Lushnje;
- caktimin e z. Kleanth Zeka, prokuror në Prokurorinë e Apelit Vlorë, për përfaqësimin e akuzës në një çështje në gjykim, pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë.

Gjithashtu, u miratuan projektakti " Për rillogaritjen dhe pagesën e diferencës së pagës së papaguar të anëtarëve dhe ish anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për periudhën nga data 01.01. 2019 deri 28.5.2021", si dhe ai për një ndryshim në vendimin Nr.157, datë 27.06.2022, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë "Për praktikën profesionale të kandidatëve për magjistratë të Shkollës së Magjistraturës".

# KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

[RRETH NESH](#)[NJOFTIME](#)[SEANCA PLENARE](#)[LEGJISLACION](#)[PROGRAMI I TRANSPARENCËS](#)[SEANCË DËGJIMORE](#)

Këshilli do të ketë në dispozicion edhe 45 ditë të tjera për t'u njohur me dokumentacionin dhe platformat e aplikantëve që do shprehin dëshirën për të kandiduar si dhe zhvillimin e seancave dëgjimore me seicilin prej tyre, me qëllim që, deri në datën 18.12.2022, të mundësohet zgjedhja e drejtuesit të ri me mandat 3 – vjeçar.

Këshilli shtyu miratimin e disa ndryshimeve në Rregulloren “Për transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele”, saj në mbledhjen e radhës.

Në përfundim të mbledhjes anëtarët e Këshillit diskutuan mbi seicilin prej 12 rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për veprimtarinë e Këshillit të Lartë të Prokurorisë përgjatë vitit 2021, duke pranuar se disa nga këto rekomandime janë iniciuar si procedura nga ana e institucionit, gjithsesi, u vendos për hartimin e një planveprimi me hapa konkret.

[< Seanca plenare nr.148](#)

PËR NGRITJEN NË DETYRË NË  
SHKALLËT MË TË LARTA NË  
PROKURORITË E JURIDIKSIONIT  
TË PËRGJITHSHËM >